



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-039
Prishtinë, më 12, 13, 23 dhe 26 korrik 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 12, 13, 23 DHE 26 KORRIK 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Halit dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2018.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Naser Rugova, Bekim Haxhiu, Rexhep Selimi, Shqipe Pantina, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Armend Zemaj, Teuta Haxhiu dhe Mimoza Kusari-Lila, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili në lidhje me veprimet e ndërmarra nga kjo ministri, për raportimet nga mediat se institucionet shëndetësore i kanë mashtruar pacientët me numrin e stendave të vendosura.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me pagesat e shërbimeve shëndetësore jashtë institucioneve shëndetësore publike.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili në lidhje me pagesat e shërbimeve shëndetësore jashtë institucioneve shëndetësore publike.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve nga kjo ministri për realizimin e projektit për asfaltimin e rrugës Smolicë - Nivokaz.

Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me funksionalizimin e Rezonancës Magnetike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, si dhe për mundësinë që edhe spitalet e përgjithshme të kenë Rezonanca Magnetike.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me planet e kësaj ministrie për rregullimin dhe zgjerimin e rrugës magjistrale Gjilan - Ferizaj.

Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Salih Zyba i parashtrroi pyetje ministrit të Administratës Publike, Mahir Jagxhilar, në lidhje me pagesën e qerasë për hapësirat dhe objektet kat dhe objektet ku është e vendosur Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit.

Ministri Mahir Jagxhilar nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Sami Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me procesin për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës për pensionet e qytetarëve të Kosovës që kanë punuar në Zvicër.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Sami Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me planet e qeverisë për hapjen e një vendkalimi kufitar në mes Kosovës dhe Maqedonisë, në Stanaj - Bellanoc, në rrugën Gjilan – Kumanovë (Maqedoni).

Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Valon Ramadani i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me planet e kësaj ministrie për rregullimin e rrugës që lidhë fshatrat Tërrn dhe Bablak me magjistralen Ferizaj - Prishtinë.

Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Valon Ramadani i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj në lidhje me ndërprerjen e punimeve për ndërtimin e rrugës ndërkomunale mes fshatrave Komogllavë (Ferizaj) dhe Trestenik (Viti).

Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrroi pyetje Kryeministrit Ramush Haradinaj, në lidhje me pezullimin e shqyrtimit të kërkesave të komunave për kthimin e pronave publike të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në pronësi të komunave.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrroi pyetje Ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me funksionalizimin e aparaturave të blera nga projekti “modernizimi i shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Mirjeta Kalludra i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me konkursin e fundit për zyrtar policorë.

Ministri Bejtush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Mirjeta Kalludra i parashtrroi pyetje Ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me planet e kësaj ministri për blerje të më shumë aparaturave të Rezonancës Magnetike për nevojat e pacientëve.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Doruntinë Maloku-Kastrati i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj në lidhje me përfundimin e punimeve për zgjerimin e rrugës magjistrale Podujevë - Prishtinë.

Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Nezir Çoçaj i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me planet e kësaj ministrie për fillimin e punimeve për rregullimin e rrugës në rajonin e Hasit.

Ministri Pal Lekaj, nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me masat e ndërmarra nga kjo ministri për shkollimin dhe aftësimin profesional të personave të mitur në qendrat korrektuese.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me masat e ndërmarra nga kjo ministri ndaj personave përgjegjës për publikimin e testeve të maturës.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me vdekjen e një të riu në vendin e punës.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Fitore Pacolli i parashtrroi pyetje zëvendëskryeministrit & ministrit të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, në lidhje me dekarimet e tij për hapjen e zyrave diplomatike të Kosovës në Greqi dhe Sllovaki.

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli, nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtrroi pyetje ministrit të Financave, Bedri Hamza, në lidhje me një kërkesë të Komunës së Prizrenit për shtimin e numrit të zjarrëfiksëve në atë komunë.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje Ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me mjekët specialistë të papunë dhe planet e kësaj ministri për punësimin e tyre.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Elmi Reçica i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me planet e kësaj ministrie për realizimin e projektit për kyçje të Ferizajt në Autostradën “Arbën Xhaferi”.

Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Në vazhdim, kryetari i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Nait Hasani, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe për shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e kësaj pike.

Kryetari kërkoi deklarinimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartcekur.

Në lidhje me propozimin e lartcekur diskutuan: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari për mungesë të kuorumit nuk e hodhi në votim propozimin për plotësimin e rendit të ditës.

Për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, kryetari e ndërpreu seancën në orën 17:45, për të vazhdua më 13 korrik 2018, në orën 10:00.

E premte, më 13 korrik 2018
Vazhdimi i seancës plenare

Seancën e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi në fillim të Seancës plenare e hodhi në votim mocionin e kryetarit të Komisionit Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Nait Hasani, për plotësimin e rendit të ditës me pikën: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit, por nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Pastaj, kryesuesi procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, diskutuan deputetët: Hajdar Beqa, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër

Korrupsionit dhe në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Shkumbin Demaliaj në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Bahrim Shabani, në emër të GP “6+”, Islam Pacolli, Sami Kurteshi, Milaim Zeka, Fitore Pacolli, Zafir Berisha, Liburn Aliu, Adem Mikullovc, Ismajl Kurteshi, Arbër Rexhaj, Gani Dreshaj, Albin Kurti, Salih Zyba, Teuta Haxhiu, Emilija Rexhepi, Rexhep Selimi dhe Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, si dhe ministri Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë Projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, diskutuan deputetët: Hajdar Beqa, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Shkumbin Demaliaj në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Fitore Pacolli dhe ministri Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij Projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 77,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen e Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligji.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij Projektligji.

Lidhur me Projektligjin nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, diskutuan deputetët: Hajdar Beqa, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të PDK-së; Fatmire Kollçaku, në emër të GP të LVV-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Sami Kurteshi, Arbërie Nagavci dhe Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij Projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 81,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen e Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar Projektligjin për qasje në dokumentet publike dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit për qasje në dokumentet publike. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë Projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike, diskutuan deputetët: Xhevahire Izmaku, në emër të Komisionit për Administratë Publike dhe në emër të GP të PDK-së; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së dhe Drita Millaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 69,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike.

2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 16:50.

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Në vazhdimin e Seancës plenare Kuvendi i miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin, Projektligjin nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, Projektligjin nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës dhe Projektligjin nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike. Rezultatet e votimeve janë pasqyruar së bashku me shqyrtimet e pikave përkatëse.

Pastaj, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës si në vijim:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ismajl Kurteshi e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 48 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim përnjëherë të gjitha amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi amendamentet nga 1 deri në 48.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për gjak dhe përbërës të gjakut dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Besa Baftiu e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 55 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54 dhe 55.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin: 39.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 71,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/ L-009 për ndërmjetësim

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për për ndërmjetësim dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, Albulena Haxhiu, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 30 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim përnjëherë të gjitha amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi amendamentet nga 1 deri në 30.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 7.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/ L-009 për ndërmjetësim.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/ L-010 për noterinë

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për noterinë dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, Albulena Haxhiu e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 57 amendamente.

Kryetari i hodhi disa herë në votim amendamentet e propozuara, mirëpo nuk pati kuorunit të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Në vazhdimin e Seancës plenare më 26 korrik 2018, gjithashtu u hodhën përsëri në votim amendamentet e propozuara, mirëpo nuk pati kuorunit të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Me vendim të Kryesisë Kuvendit, votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/ L-010 për noterinë shtyhet për seancën tjetër të radhës.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare më 23 korrik 2018, në orën 14:50.

Kryetari i Kuvendit:
KADRI VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*